

Editorial/

Një lexim vertikal i ngjarjeve në vendet arabe

Nga hoxhë **Justinian Topulli**



Çdo shoqëri njerëzore dhe çdo komb e ndërton jetën e tij mbi vlera të caktuara, të cilat nga ana e tyre përcaktojnë mënyrën e jetës, kufizimet dhe botëkuptimin e kësaj shoqërie për jetën. Burimi kryesor, që i ka imponuar vlera shoqërisë arabe –por jo vetëm- më shumë se çdo burim tjetër, për katërbëdhjetë shekuj ka qenë dhe mbetet feja islame. Kjo fe u ka dhënë arabëve vlera, me të cilat ata janë përshtatur mjaft mirë dhe me kalimin e kohës ato nuk kanë krijuar konflikte që prishin ekuilibrin psikik, emocional, fizik, material dhe shpirtëror të këtyre shoqërive, ndaj dhe vlerat e kësaj feje vazhdojnë të jetojnë fuqishëm mes këtyre popujve. Njerëzit e këtyre shoqërive kanë jetuar për shumë kohë në paqe me vetveten dhe shoqërinë e tyre, natyrisht për aq kohë sa nuk ka pasur devijime çekuilibruese të këtyre vlerave nga jashtë apo nga brenda shoqërisë.

Diçka krejt e ndryshme ka ndodhur p.sh. me shoqërinë perëndimore, besimet dhe feja që ka sunduar në këtë pjesë të botës, vlerat që ato kanë formuar dhe shtresëzuar për shekuj me radhë kanë krijuar me kalimin e kohës një rend të pakuilibruar psikik, emocional, fizik, material dhe shpirtëror, ndaj qe më se normale që kjo shoqëri të kërkonte shtigje dhe hapësira të reja për të plotësuar nevojat e privuara nga ky rend sundues shoqëror. Por, rendi shoqëror që ruante këto “vlera-privime”, për të ruajtur vazhdimësinë e tij tentoi që me mjetet e tij në dispozicion të mbante nën kontroll gati absolut mbi individët e kësaj shoqërie dhe për këtë ai shkoi drejt shtypjes së dhunshme të individëve, të cilët nga ana e tyre radikalizuan reagimin gjithmonë e më shumë në kohë. Rebelimi ndaj këtij rendi shoqëror dhe vlerave të tij u bë një nga opsionet më të preferuara të shoqërisë perëndimore, ndërkohë ky rebelim nga ana e tij si proces krijoi çarje, të cilat me kalimin e kohës dolën jashtë kontrollit, ato u zmadhuan aq shumë sa përmbysën gjithë rendin e mëparshëm, duke krijuar një rend të ri, i cili ruan shumë pak vlera nga ai i mëparshmi.

Çdo rend i ri shoqëror që krijohet ka idealet dhe besimet e tij, të cilat i

shndërron në vlera, që kërkon më pas t'i ruajë për të ruajtur vazhdimësinë e tij. Rendet që përmbysen dhe zëvendësojnë njëra-tjetrën sa herë që ndjehen të rrezikuar gjithmonë tentojnë ta ruajnë vetveten duke shtrirë sa të mundin kontrollin mbi individin, kështu që shpesh liria e individit, e ngritur në vlerë dhe e përdorur si armë për të përmbysur rendin e vjetër nga rendi i ri, bëhet e rrezikshme për vetë rendin e ri, ndaj dhe merr gjithmonë ngjyrimet e veçanta në çdo rend dhe në përputhje me vlerat e tij.

Pra kurrë nuk ka ekzistuar dhe s'ka për të ekzistuar shoqëri me një liri absolute, ku individit të jetë plotësisht i lirë në jetën e tij, pa kufizimet që vendosin vlerat e rendit sundues, në të kundërt nuk do të kishte më një shoqëri njerëzore, por një kaos i vërtetë.

Kështu pra një rend i mirë dhe i qëndrueshëm shoqëror, nuk është ai që ka më shumë aftësi dhe mjete të shtrijë kontrollin e tij mbi individin dhe nëpërmjet tij mbi mbarë shoqërinë, por ai që krijon dhe mbart vlera, të cilat ruajnë harmoninë dhe ekuilibrin e njeriut me vetveten, natyrën dhe shoqërinë e tij. Një rend i tillë kurrë nuk do të “zbulohet” apo “arrihet” nga “evolucionet e mutacioneve sociale”, apo më saktësisht nga rebelimet e pakontrolluara ëndërrimtare, ai mund vetëm të dhurohet, sigurisht nga Ai që krijoi njeriun.

Çështja pra shtrohet te zgjedhja që shoqëritë njerëzore bëjnë dhe jo te zgjidhjet që provojnë. Kjo është liria e vërtetë.

Intelektualët e botës perëndimore –në përgjithësi- mendojnë se, vlerat si shekullarizmi dhe demokracia liberale që lidhet me të, janë vlera të cilat edhe pse lindën dhe u zhvilluan në perëndim në situata dhe kushte të caktuara si periudha e iluminizmit dhe industrializimit evropian, ato duhet jenë universale për mbarë botën. Ky vetëbesim për universalizmin e këtyre vlerave -i kthyer gati në një fe të re- i ka shtyrë perëndimorët të mos kuptojnë siç duhet botën arabe dhe atë islame, në veçanti dallimet thelbësore kulturore dhe sociale që i ndajnë këto botë, dhe

mbi gjithçka dallimet mes vlerave që ka gjeneruar secila fe në të dyja këto shoqëri. Vetëbesimi në universalizmin e vlerave dhe nganjëherë edhe moskuptimi i tjetrit i shtynë njerëzit në luftë dhe konflikt të pandërprerë me të tjerët. Ky konflikt sot më shumë se i armatosur ka marrë përmasën e një beteje ideologjike në vendet arabe mes një pakice që aspiron të ndjekë perëndimin gati në çdo gjë dhe një shumicë që kërkon kthim tek vlerat e vjetra fetare. Ajo çka e përshtjellon më shumë qartësinë e këtij konflikti, është pjesa e pakët laike e këtyre shoqërive, të cilët nuk i përkasin elitave sunduese laike të korruptuara që po përmbysen, por që i janë bashkëngjitur shumicës fetare si aleat në përmbysjen e regjimeve autoritariste të korruptuara arabe. Kjo aleancë e brishtë interesash tranzitore duket se është shfrytëzuar mirë nga jashtë, sidomos nga ata që mendojnë se një konflikt i brendshëm i tejzgjatur në këto vende do të shmangë konfliktet e armatosura të motivuara fetarisht si dhe krijon premisat për ardhjen në pushtet të diktaturave të reja ose të dikurshme, që garantonin dje një paqe relative në rajon.

Arsyeja pse bota dhe në veçanti ajo perëndimore akoma nuk po mban një qëndrim të qartë dënues ndaj puçit ushtarak në Egjipt dhe nuk po ndërhyjnë në konfliktin e përgjakshëm sirian, është ndër të tjera edhe fakti se ajo e kupton mjaft mirë situatën aktuale të pranverës së dyzuar arabe, në një anë, dhe luftës

së ish regjimeve ushtarake për të ruajtur pushtetin me çdo mënyrë, në anën tjetër. Por qëndrimi dyzuar perëndimor, mes vlerave të tij demokratike, interesave afatgjatë në këtë zonë dhe frikës së një konflikti të armatosur në shkallë të gjerë në rajon, e ka përshtjelluar edhe më shumë situatën në këto vende. Nuk ka gjasa se gjendja do të stabilizohet shpejt dhe nëse ajo stabilizohet nuk dihet se çfarë kahu ajo do të marrë. Në një situatë të tillë të paqartë politike duket se ngjarjet kanë mundësi të rrjedhin drejt një të panjohure, që gjithsesi nuk do të dal jashtë rrethit të parashikimeve të të gjitha palëve. Lusim Zotin të bëjë më të mirën!

Deshekullarizimi i botës

Mjaft studies laike të sotëm, habiten me rigjallërimin global të fesë në mesin e njerëzve, pasi iu ishte ngulitur në kokë më parë nga teoricienë të ndryshëm, se racionalizimi dhe modernizimi i jetës, me kalimin e kohës do të shpinte pashmangshëm në zhdukjen apo venitjen e religjionit. Për këtë arsye, kjo temë është bërë një temë studimi mjaft interesante për ta.

Në fakt, siç shkruan edhe një sociolog bashkëkohor, laicizmi si fenomen, është shumë më i habitshëm dhe interesant për tu studiuar, sesa religjioni, kjo, sepse religjioni dhe besimi fetar kanë qenë

Vijon në faqen 3...

Fq.4/ Jurisprudencë/ Dispozita e Akikas në Islam

Nga Halef bin Muhamed el Halef

Fq.5/ Etikë/ Disa rregulla të “odës”

Nga hoxhë Ulvi Fejzullahu

Fq.6/ Histori/ Metodrat dhe rrugët që u përdorën kundër thirrjes islame

Fetva/

Blerja e aksioneve të shoqërive apo bankave që kanë një pjesë të transaksioneve të tyre të lidhur me kamatën

Akademia e Fikhut Islam me qendër në Mekë

Lavdia i takon vetëm Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin për Profetin tonë Muhamed, pas të cilit nuk ka Profet tjetër, për familjen dhe shokët e tij.

Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam në sesionin e saj të katërbëdhjetë të zhvilluar në Mekë e nderuar në datën 20 Shaban 1415 h./21 Janar 1995 e.s. mori në shqyrtim temën e mësipërme dhe vendosi:

1- Duke qenë se në parim tregtia është e lejuar, atëherë edhe hapja e një shoqërie aksionare me qëllime dhe aktivitete të lejuara, nga ana fetare është e lejuar.

2- Nuk ka asnjë mospajtim në mes dijetarëve se, është e ndaluar të bëhesh pjesë e shoqërive që kanë si qëllim kryesor të tyre diçka të ndaluar, siç është kamata, prodhimi i produkteve të ndaluara apo tregtimi i tyre.

3- Muslimanit nuk i lejohet që të blejë aksione nga shoqëritë apo bankat të cilat një pjesë të transaksioneve të tyre i kanë të lidhur me kamatën, nëse blerësi ka dijeni për diçka të tillë.

4- Nëse një person blen aksione pa e ditur se shoqëria ka marrëdhënie me kamatën dhe informohet më pas për këtë, atëherë ai e ka për detyrë të tërhiqet prej saj.

Ndalimi i pjesëmarrjes në të tilla shoqëri është më se i qartë, nisur kjo nga argumentet e përgjithshme në librin e Allahut dhe në Sunetin Profetit, që ndalojnë kamatën. Blerja e aksioneve nga shoqëritë që veprojnë me kamatë, me dijeni të plotë të blerësit, do të thotë që edhe vetë blerësi është bashkëpjesëmarrës në kamatë, sepse aksioni nuk është gjë tjetër vetëm se një pjesë e shpërndarë e pasurisë në të gjithë kapitalin e shoqërisë, si rrjedhojë, aksionari ka në pronësi të tij një pjesë të shpërndarë të aseteve të shoqërisë, për pasojë, çdo pasuri që shoqëria e merr apo e jep si kredi me fajde, aksionari ka pjesën e tij në këtë drejtim, po ashtu edhe për faktin se ata që marrin përsipër marrjen apo dhënien e kredisë e bëjnë këtë në emër të aksionarit dhe çdo autorizimi që jepet për të bërë një vepër të ndaluar është e ndaluar.

Paqja dhe bekimi qoftë për zotërinë tonë Muhamedin, vulën e profetëve, për familjen dhe mbarë shokët e tij.

Burimi: <http://www.themwl.org/Fatwa/default>

Blerja e mallit të dhuruar

*Komisioni i Përhershëm i Fetvave në Mbretërinë e Arabisë Saudite
Vëllimi 13 / faqja 142*

Pyetja e parë e fetvasë nr. 10635: Një burrë i dhuroi vëllait të tij një makinë, më pas ai që iu dhurua kjo makinë donte ta shiste atë. A i lejohet të parit që e dhuroi këtë makinë ta blejë atë apo nuk i lejohet?

Përgjigje: Atij që dhuron diçka nuk i lejohet që ta blejë atë që ia ka dhuruar vëllait të tij. Nga Omeri (r.a.) përcillet se ka thënë: "I dhurova dikujt një kalë për ta përdorur në rrugën e Allahut, por i zoti nuk kujdesej për të, ndaj mendova se ai mund ta shesë atë lirë. E pyeta të Dërguarin e Allahut (a.s.) për këtë dhe ai tha "Mos e ble, edhe nëse ta jep vetëm për një dërhem, sepse ai që kthehet dhe e kërkon edhe një herë lëmshën që ka dhënë është si geni që kthehet tek ushqimi që ka vjellë më parë." (Buhariu & Muslimi)

Allahut i mbështetemi. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe ndjekësit e tij.

Burimi: <http://www.alifta.net/Fatawa/FatawaChapters.aspx?View=Page&BookID=3&PageID=4693&back=true>

A lejohet marrja e përkrahjes sociale në këtë mënyrë?

Selamu Alejkum! Vëlla i nderuar fillimisht e lus Allahun që të jeni mirë ju dhe familja juaj si me iman ashtu edhe me shëndet. Pak me poshtë kam përgatitur disa çështje me të cilat përballen muslimanet ne vendet perëndimore dhe duan të dinë si është gjykimi islam mbi këto. Jua dërgova ju këto çështje duke ditur se keni forumin e hoxhallarëve ku diskutoni për çështje islame, t'i diskutoni me njëri tjetrin dhe inshallah për çdo njërin prej tyre të na jepni përgjigje nëse kjo gjë nuk përbën ndonjë problem na ana juaj.

1. Në bazë të ligjeve këtu nëse një individ është i papunë, ai merr asistencë sociale deri sa te gjeje një vend pune, kjo asistencë është me se e mjaftueshme për nevojat elementare si ushqimi, veshja...etj.

Pyetja: Ndodh që dikush paraqet ne zyrën e punës letrat si i papunë dhe përfiton asistencën mujore dhe punon në të zezë (fshehurazi) në të njëjtën kohë dhe këtë e bën qëllimisht që ta marrë asistencën si i papunë. A përbën kjo problem?

2. Për familjet të cilat nuk plotësojnë minimumin jetik me të

ardhura mujore (shumën e caktuar) shteti ka programe sociale dhe ajo familje përfiton ndihma, si p.sh. paguan gjysmën e qerases.... etj.

Pyetja: Ka persona te cilët regjistrohen ne tjetër shtëpi dhe nuk banojnë fare aty vetëm me qëllim që ta rrisin numrin e anëtareve dhe te përfitojnë nga këto ndihma mujore. A ka problem?

3. (Kjo është e ngjashme me të dytën) Nëse një punëtor e ka rrogën mujore nen minimumin jetik (te caktuar) përfiton ndihma nga shteti.

Pyetja: Nëse rroga ime është mbi minimumin jetik a ka problem nëse i them pronarit që ne dokumente te ma shkruaj rrogën te vogël, nen minimum kurse ne realitet rrogën mos te ma uli por te ma japi ne dore te plote.

4. Kur dikush sëmuret dhe shkon ne spital merr raport mjekësor, firma ku punon është e detyruar që gjate ditëve me raport ta paguaje dhe mos ta detyroje te vije ne pune.

Pyetja: Ka persona te cilët pa qene te sëmure shkojnë dhe marrin raport vetëm me qëllim që te bëjnë pushim. A ka problem?

5. Ndhima për emigrantet e papune shkon me ane te Karitasit projekt i cili është ne bashkëpunim me shtetin. Ne këto ndihma nuk ka kurrfarë kushtesh mjafton te jesh i papune pra pa te ardhura mujore dhe ata te ndihmojnë me asistencë.

Pyetja: Kjo ndihme nga Karitasi i cili është ne bashkëpunim me qeverinë ka problem te merret?

Jam munduar te jem i qarte ne formulimin e pyetjeve inshallah ia kam arritur.

Allahu jua shpërbleftë!

Përgjigje: Me Emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Në kushte normale marrëdhëniet në mes muslimanëve dhe jomuslimanëve në çështje që kanë të bëjnë me këtë botë janë të ngjashme si ato ndërmjet vetë muslimanëve. Pra, nuk lejohet që ata të mashtrohen, të vidhen, të cenon në nder, në pasuri dhe në çdo gjë tjetër që nuk miratohet nga etika islame, për më tepër kur kemi të bëjmë me mosrespektim të një marrëveshje. Një njeri i tillë, që vepron siç përmendet në pyetjet e mësipërme, ka thyer një marrëveshje që ai ka bërë me shtetin, qoftë ai edhe shtet jomusliman. Marrëveshjet nëse janë brenda normave të lejuara islame duhet të përmbushen, qofte me muslimanin apo jomuslimanin. Veç kësaj qëllimi i një asistencë sociale është të ndihmojë atë që s'ka dhe jo atë që ka, dhe siç tregohet edhe në pikën nr. 3 të pyetjes rrogën ky njeri e ka mbi nivelin më të ulët për të jetuar, kështu që për të nuk lejohet të marrë nga ajo asistencë.

Muslimani është i urdhëruar të përmbushë me sinqeritet detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e ndryshme,

me cilin do qoftë ajo, me musliman ose jo. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: "O besimtarë! Plotësoni detyrimet!" (5:1) Fjala detyrimet në këtë ajet në gjuhën arabe është ukud, shumësi i fjalës akd, apo akt në shqip, dhe si e tillë ajo përfshinë çdo detyrim që rrjedh nga marrëveshjet dhe aktet e ndryshme. Ajeti është gjithëpërfshirës dhe nuk bën përjashtim për jomuslimanët. Po kështu nuk kemi asnjë argument nga Suneti se në kushte normale i lejohet muslimanit të mashtrtojë një jomuslimanë, përkundrazi kemi shembuj të shumtë profetik të përmbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve me jomuslimanët.

Veç kësaj është e rëndësishme të theksojmë se sjellje të tilla prishin imazhin e një muslimani dhe vetë Islamit, duke ndikuar negativisht në shtimin e islamofobisë dhe në mbylljen e derës së thirrjes islame karshi këtyre njerëzve.

Kështu që për të katër pikat e para që përmenden në pyetje nuk lejohen të veprohen, sepse janë metoda mashtruese dhe mashtrimi nuk lejohet në fenë islame, përveç rasteve të veçanta të domosdoshme, raste këto që nuk përfshihen në asnjë nga ato që përmenden në pyetjet e mësipërme.

Ndërsa për sa i përket pyetjes së pestë, përgjigja për të është: Nëse shoqata e katolike e Karitasit nuk vendos asnjë kusht për ndarjen e këtyre ndihmave që cenon dukshëm ose indirekt fenë e muslimanit apo edhe atë vetë, atëherë nuk ka ndonjë pengesë që ndihma të merret me ndërmjetësinë e tyre.

Allahu e di më së miri

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة البانيا
The Albanian Imam's League



www.lidjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidjahoxhallareve@yahoo.com

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TERNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri
lidjahoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidjahoxhallareve.com>

Cikli i haditheve të dobëta dhe të trilluara

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Nga libri: "110 Virtyte të Imam Aliut"

HADITHI NR. 8:

Transmetohet nga Ebu Ahmedi, Ibn Mendeh dhe të tjerë përveç këtyre dyve, nga zinxhiri i Is'hak ibn Bishr el-Esdiut, prej Khalid ibn el-Harithit, prej Afit, prej el-Hasanit, prej Ebu Lejla el-Ghifariut, i cili tha: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s) duke thënë: "Do të ketë fitne pas meje. Kur ajo të ndodhi, kapuni pas Ali ibn Ebi Talibit. Padyshim ai është i pari që besoi në mua dhe i pari që do të më përshëndesë në Ditën e Gjykimit. Ai është miku i sinqertë më i madh (siddiku akbar), kriteri dallues (faruku) i këtij ummeti. Ai është strehimi i besimtarëve, ndërsa paraja është strehimi i hipokritëve."

Grada e hadithit: Këtë transmetim e përcjell Ibn Haxheri në: "El-Isabeh fi temjizissahabe" 7/167 dhe po aty përmend se Is'hak ibn Bishr el-Esdiu që ndodhet në zinxhirin e transmetuesve e kane braktisur dijetarët e hadithit dhe kjo për shkak se atë e akuzojnë si gënjeshtar. Po ashtu këtë hadith e transmeton Bezzari në Musnedin e tij 9/342 dhe në zinxhirin e transmetuesve ndodhet Muhamed ibn Ubejdilah ibn Ebi Rafi të cilin e konsiderojnë tepër të dobët në transmetime Buhariu, Jahja ibn Meini dhe të tjerë.

Të gjitha këto transmetime të dobëta pohojnë se Aliu është i pari musliman që e ka besuar Profetin Muhamed (a.s.). Siç shikohet përpjekjet për ta bërë Aliun më të mirin e sahabëve janë të shumëllojshme duke e servirur figurën e tij të lidhur me fillimin dhe mbarimin e Islamit, madje duke u përpjekur t'i jepen atij virtytet që në realitet i kanë gëzuar sahabët e tjerë. Përshembull në hadithin nr. 8 përmendet se Aliu është siddiku i këtij umeti, ndërkohë është Ebu Bekri ai i cili e ka merituar këtë virtyt të lartë dhe askush tjetër përveç tij. Gjithashtu aty përmendet se ai është faruku i këtij umeti, ndërkohë është Umeri ai i cili e ka merituar këtë cilësi të lartë dhe askush tjetër përveç tij. Ngritja e figurës së Aliut dhe veshja e tij me virtytet e sahabëve të tjerë dhe lidhja e figurës së tij me fillimin dhe mbarimin e Islamit është përpjekja fillestare për të ngritur lart kultin e Aliut dhe uljen e figurës së sahabëve të tjerë të Profetit (a.s.) dhe me këtë mënyrë bëhen përpjekje të përshkallëzuara për të integruar shiizmin në mesin e muslimanëve suni.

Këto transmetime përveçse janë të dobëta e të trilluara bien në kundërshtim me transmetimet e tjera të sakta. Përshembull, Imam Buhariu shënon në Sahihun e tij (hadithi nr. 3) dhe Muslimi në Sahihun e tij (hadithi nr. 159) se Profeti (a.s.) sapo i erdhi shpallja hyjnore nëpërmjet engjëllit Xhibril shkoi në shtëpi dhe ia tregoi të gjithë ngjarjen Hatixhes, bashkëshortes së tij, e cila jo vetëm që e besoi menjëherë shpalljen

hyjnore por dhe e inkurajoi Muhamedin (a.s.) se Allahu nuk do ta braktiste atë. Pra ky transmetim tregon qartë se i pari njeri që është bërë musliman është Hatixhja. Dijetarët islamë ndajnë mendime të ndryshme rreth personit i cili e ka pranuar Islamin pas Hatixhes. Vetë Ebu Bekri pohon për veten e tij se ai është i pari që ka pranuar Islamin siç transmeton Tirmidhiu nr. 3667. Të njëjtën gjë pohon për të Ibn Abbasi i cili mësohet të ketë thënë në një thënie tjetër se Aliu e ka pranuar Islamin para Ebu Bekrit. Ndërsa Imam Ibn Shihab Ezzuhri, imam Urve ibn Zubejri dhe të tjerë mendojnë se i pari Musliman pas Hatixhes është Zejd ibn Harithe. Ndërkohë në Musnedin e Bezarit 2/230 shënohet se Abdurrahman ibn Aufi pohon për veten e tij se është ai që e ka pranuar Islamin i pari. Kurse Hisham Ibn Saib ibn Muhamed el-Kelbi (njëri prej komentuesve të Kuranit) pretendon se pas Hatixhes është Ummul Fadl Bint el-Harith ajo që e ka pranuar Islamin para të tjerëve. (Akhbar Mekke 3/216) Përveç kësaj kemi dhe transmetime nga vetë Profeti (a.s.) ku shënohet se Ebu Bekri është i pari që e ka pranuar Islamin, mirëpo shumica e këtyre transmetimeve janë të dobëta ose të trilluara.

Nga kjo mësojmë se pas Hatixhes nuk mund të pretendohet për askënd tjetër në formë të prerë se është pikërisht ai që e ka pranuar Islamin i pari. Kjo do të thotë se nuk mund të veçojmë Islamin e Aliut si një virtyt më tepër karshi sahabëve të tjerë, Për këtë arsye shohim se shumë prej dijetarëve islamë, për të qëndruar objektivë në këtë çështje dhe për të mos ngritur figurën e njërit mbi një tjetër kanë thënë: "I pari që e ka pranuar Islamin prej burrave është Ebu Bekri. E para që e ka pranuar Islamin nga gratë është Hatixhja. I pari që e ka pranuar Islamin nga fëmijët është Aliu dhe i pari që e ka pranuar Islamin nga shërbëtorët është Zejdi."

HADITHI NR. 9:

Umer ibn el-Khattabi tha: "Dëshmoj se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: "Sikur shtatë qiejt të vendoseshin në një rën pjatë të peshores dhe imani i Aliut në tjerën, imani i Aliut do të rëndonte më shumë."

Grada e hadithit: Këtë hadith e përcjell Dejlemiu ne Musnedin e tij nr. 5138 dhe Ibn Asakir në "Tarih Dimeshk" 42/341, ndërsa imam Dhehebiu në "Mizanul -i'tidal" 3/494 tregon se ky hadith është tepër i dobët, në zinxhirin e të cilit gjendet Muhamed ibn Tesnim el-Verrak i cili është i panjohur si transmetues. Ndërkohë hadithi ka transmetues të tjerë të panjohur të cilët e bëjnë të papranueshëm në formë kategorike.

HADITHI NR. 10:

Ebu Mes'ud el-Ensariu tha: "I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: "Kushdo që fal namaz (salat) dhe nuk dërgon salavat

mbi mua dhe Ehli Bejtin tim, namazi i tij nuk pranohet."

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Darekutni ne Sunenin e tij me nr. 1343 ku vetë imam Darekutni e bën të dobët hadithin, sepse në zinxhirin e transmetuesve gjendet Xhabir ibn Jezid el-Xhu'fi të cilin e kanë cilësuar si gënjeshtar shumë dijetarë të hershëm. Njëri prej tyre është dhe imam Ebu Hanife.

HADITHI NR. 11:

Prej Shehr ibn Hashebit prej ummi Selemes, e cila tregon se i Dërguari i Allahut (a.s.) i tha Fatimesë: "Sille yt shoq dhe dy fëmijët tuaj! Porsa ajo i sollti, ai (a.s.) hodhi mbi ta një batanije të veçantë leshi dhe pastaj vendosi dorën e tij mbi ta. Atëherë, ai tha: "O Allah! Këta janë Familja e Muhamedit! Prandaj dërgoji salavatet dhe bekimet e Tuaja mbi Muhamedin dhe mbi Familjen e Muhamedit. Ti je më i Lavdëruari, më i Madhërishti!"

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton imam Ahmedi në Musnedin e tij 6/323 dhe në zinxhirin e transmetuesve ndodhet Ali ibn Zejd ...ibn Xhud'ani të cilin e kanë bërë të dobët një mori dijetarësh, prej tyre dhe vetë imam Ahmedi. Po ashtu në zinxhirin e transmetuesve gjendet dhe Shehr ibn Hausheb i cili konsiderohet si transmetues i dobët te shumë dijetarë të hadithit.

HADITHI NR. 12:

Transmetohet nga i Dërguari i Allahut (a.s.): "Mos dërgoni salavat të cunguar mbi mua!" E pyetën: Cështje salavati i cunguar? Ai u përgjigj: "Të thoni: "O Allah! Dërdhi bekimet e Tuaja mbi Muhammedin!" e pastaj të ndaloni. Në vend të kësaj, thoni: "O Allah! Dërdhi bekimet e Tuaja mbi Muhamedin dhe Familjen e Muhamedit!" (Allahumme sal-li ala Muhamed ua ala ali-I Muhamed)."

... Vijon nga faqja 1

gjithmonë aty, për mijëra vjet shoqëruet të njeriut, që nga kohët që s'mbahen mend, ndërsa laicizmi me këtë pamje dhe dimension që ka sot, është relativisht i ri dhe i habitshëm, ndaj dhe një temë shumë më interesante për tu studiuar, sesa vazhdimësia e fesë në shoqëritë njerëzore.

Laicizimi i shoqërisë nuk është gjë tjetër vetëm se një nga përpjekjet e njerëzve "për t'u çliruar" nga kufizimet fetare dhe morale të shoqërisë, "për të fituar pavarësinë" nga Zoti, pra për të mëkatuar.

Që njerëzit të fitojnë këtë "siguri" për të ngritur krye ndaj fesë dhe vlerave të trashëguara morale të shoqërisë, u duhet një burim force, që t'i bind ata se, "rebelimi" i tyre është i pacenueshëm. Këtë siguri të brishtë historikisht ua ka ofruar pasuria dhe pushteti; Zoti thotë në Kuran: "Por vërtetë njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i

Grada e hadithit: Këtë hadith siç përmendet edhe në libër e përmend Ibn Haxher el-Mekki në "Essawaik ul-mushrika" mirëpo aty nuk e përmend zinxhirin e transmetuesve, ndërkohë ky transmetim nuk gjendet në koleksionet e njohura të hadithit. Kjo gjë e bën transmetimin të papranueshëm. Përveç kësaj shikojmë se Ibn Haxher el-Mekki e ka përmendur këtë transmetim me atë që quhet në shkencën e hadithit "Sigatut - temrid", formë e cila nuk siguron autentitetin e transmetimit aq më tepër kur ky transmetim bëhet i papranueshëm akoma më shumë kur nuk mund t'i gjejmë dot as dhe zinxhirin e transmetuesve.

HADITHI NR. 13:

Transmetohet nga Amr ibn Ebi Selemeh, djali i gruas së Profetit (a.s.), Ummi Selemeh, se kur mbi Profetin (a.s.) zbriti ajeti (Allahu dëshiron të largojë tërë ndytësinë (e mëkateve) nga ju, o Ehl ul-Bejt, dhe t'ju pastrojë me një pastrim të plotë) në shtëpinë e Ummi Selemes, ai (s) thirri Fatimenë, Hasanin e Huseinin, dhe i mbuloi ata me një mbulesë (kisa). Aliu ishte pas tij dhe Profeti (s) e mbuloi edhe atë me ta. Atëherë, ai (s) tha: "O Allah! Këta janë Ehl-i Bejti im. Largoje tërë ndytësinë e mëkateve prej tyre dhe pastroji ata me një pastrim të skajshëm!" Ummi Selemja tha: "A jam unë mes tyre, O i Dërguari i Allahut! Ai u përgjigj: "Ti ke pozitën tënde dhe je në të mirë."

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Tirmidhiu në Sunenin e tij nr. 3205 dhe po aty tregon se ky transmetim është i dobët me fjalën e tij të njohur "Garib" ku ka për qëllimin dobësimin e transmetimit. Për këtë arsye shikojmë në zinxhirin e transmetuesve të jetë Muhamed ibn Sulejman ibn el-Asbahani të cilin e kanë cilësuar si të dobët shumë shkencëtarë të hadithit.

Vijon...

vetëmjaftueshëm." (El-Alak, 6-7)

Me fillimin e erës së industrializmit dhe zhvillimit teknologjik, me rritjen e mirëqenies dhe përfitimeve të tjera materiale, njerëzit fituan një burim të ri sigurie, në dukje shumë më të fortë, për tu ndjerë të vetëmjaftueshëm, ndaj për këtë arsye mes njerëzve të epokës së industrializmit dhe shkencës gjen më shumë mohues të fesë se dikur.

Por, iluzioni i rremë "i vetëmjaftueshmërisë" që krijoi zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë, për një pjesë të madhe të njerëzimit, duket se është zbehur tej mase në dhjetëvjeçarët e fundit, kjo sepse ajo e cila supozohet ti krijonte njeriut siguri më të madhe është bërë burimi i pasigurisë më të madhe për të, kështu që ajeti i mëpasshëm i sures El-Alak "Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!" (El-Alak, 8) shpjegon mjaft qartë një nga arsyet pse shumë njerëz i kthehen sot fesë kudo në botë.

Jurisprudencë/ DISPOZITAT E AKIKAS NË ISLAM

Nga Halef bin Muhamed el Halef

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqja, begatitë dhe mirësitë e Tij qofshin mbi të dërguarin e Vet, Muhamedin, mbi shokët dhe familjen e vet.

Në terminologjinë gjuhësore, Akika do të thotë presësh diçka, ndërsa në terminologjinë islame Akika do të thotë therja e një kurbanit në shenjë falënderimi për Allahun e Lartësuar, që i dhuroi dikujt një fëmijë, qoftë mashkull apo femër. Ndryshe Akika quhet edhe Tetimeh (plotësuese), sepse ajo plotëson edukatën e të porsalindurit.

Dispozita e Akikas:

Akika është një sunet i fortë që rëndon mbi babain. Në Sahihun e Buhariut shënohet hadithi i përcjellë nga Selman bin Amir r.a. që thotë: “Kam dëgjuar të dërguarin e Allahut a.s. të thotë: “Fëmijës i takon një Akika, prandaj derdhi gjak për të dhe largojani lëndimin.”

Salihu, i biri i imam Ahmedit, thotë: I thashë babait tim: “Nëse burrit i lind një fëmijë dhe nuk ka mundësi të bëjë Akika për të, a të pëlqen më tepër që ai të marrë borxh dhe të bëjë Akika për të apo ta vonojë derisa t’i vijë lehtësimi?” Imam Ahmedit u përgjigj: “Gjëja më e rëndë që kam dëgjuar për Akikan është hadithi i Hasan bin Sumres, që përcjell nga i dërguari i Allahut a.s. se ka thënë: “Çdo fëmijë është peng i Akikës së vet.” Do të doja që ai të merrte borxh dhe Allahu t’ia zëvendësonte borxhin që ka marrë, sepse ai ringjallur një sunet prej suneteve të të dërguarit të Allahut a.s. dhe ka ndjekur shpalljen që Profeti a.s. ai ka sjellë.”

Përsa i përket atij që ka mundësi për ta bërë një Akika, atëherë është më parësore, më e mirë dhe më e plotë që ai ta bëjë dhe nëse nuk i ka mundësitë, atëherë ai nuk e ka për detyrim, duke u nisur nga thënia e Allahut të Lartësuar: “Allahu nuk e ngarkon dikë vetëm aq sa ka mundësinë” dhe thënia e Tij: “Allahu nuk ju zë ngushtë juve në këtë fe.” Gjithashtu edhe duke u nisur prej hadithit të Profetit a.s. që e përcjell Sumre: “Çdo fëmijë është peng i Akikas së vet. Për të therret në ditën e shtatë, i rruhet koka dhe i vihet emri.” E përcjelle Ahmedit dhe të katërshja, ndërsa Tirmidhiu e ka saktësuar. Përsa i përket shprehjes: “Çdo fëmijë është peng i Akikas së vet” dijetarët kanë mbajtur katër qëndrime:

1- Ai është i bllokuar dhe nuk mund të niset përpara dhe të përparojë

2- Ai është i bllokuar dhe nuk do t’i jepet e drejta e shefatit (ndërmjetësimi) për prindërit e tij derisa babai i vet të bëjë Akikan për të apo ta bëjë dikush tjetër në vend të tij.

3- Allahu do ta bëjë Akikan të pandarë prej fëmijës, tamam si një

peng që nuk largohet prej njeriut.

Imam Ahmedit thotë se kuptimi i këtij hadithi është se nëse vdes një fëmijë që nuk është bërë Akika për të, ai nuk do të ndërmjetësojë për prindërit e vet.

Sasia e Akikas:

Akika e djalit është dy dele apo desh, ndërsa për vajzën është një e vetme. I dërguari i Allahut a.s. thotë: “Kujt i lind një fëmijë dhe dëshiron të therë kurban për të, le të therë dy dele të përafërta për të dhe një të tillë për vajzën.” E përcjell Ebu Daudi, Nesaiu nga Ibn Omeri dhe Albani thotë se është i saktë.

Dy kurbanet duhet të kenë moshë, madhësi, ngjashmëri dhe shëndoshje të përafërt. Urtësia e kësaj qëndron në faktin që asnjëra prej tyre të mos jetë më e mirë se tjetra, duke e lënë më të keqen pas dore. Për këtë arsye legjislacioni islam ka parapëlqyer që të dyja delet të jenë të përafërta, pra të mbulojnë mangësitë e njera-tjetrës. Nëse dikush nuk gjen veçse një dele, atëherë ajo mjafton për të përmbushur qëllimin, por nëse Allahu ia ka dhënë të gjitha mundësitë, atëherë dy të tilla është më mirë.

Karakteristikat e kafshës që therret për Akika:

Kafshët që mund të therren për Akika janë: Deveja pesëvjeçare, lopa dyvjeçare, dhia njëvjeçare, delja ose dashi gjashtëmuajsh. Delja për Akika është më e mirë se lopa dhe deveja, sepse me këto kafshë është përcjellë edhe suneti profetik. Nga Ibn Abasi r.a. përcillet se i dërguari i Allahut a.s. ka bërë Akika për Hasanin dhe Hysejnin nga një dash për secilin.” E përcjell Ebu Daudi.

Koha e Akikas:

Sipas sunetit, koha e therjes së Akika është që në ditën e shtatë pas lindjes së foshjes. Dijetarët thonë se në kalon kjo kohë, atëherë mundet në ditën e katërmëdhjetë dhe nëse nuk arrihet në këtë ditë, atëherë në ditën e njëzet e njëte. Nëse nuk arrihet as kjo ditë, atëherë mundet në çdo ditë tjetër që mund të hahet. Akika mund të dhurohet, të jepet sadeka dhe nëse personi dëshiron mund të thërrasë shokët, të afërmit dhe fqinjët, që të marrin pjesë në të. Nëse fëmija lind të shtunën, atëherë Akika bëhet të xhumanë e ardhshme dhe nëse lind të xhumanë, atëherë të enjtën e ardhshme, pra një ditë para ditës së lindjes. Urtësia e bërjes së Akikas një javë pas lindjes qëndron në faktin se me që foshnja e kaloi një javë të tërë i gjallë, atëherë në shenjë optimizmi kjo Akikë simbolizon jetën e gjatë. Në momentet e therjes së kurbanit nuk është kusht që të përmendet me gojë



se kjo është për Akika, por mjafton që personi ta bëjë nijetin me zemër dhe kusht mbetet vetëm përmendja e Allahut gjatë therjes. Akika bën pjesë në dispozitat që i përkasin kurbanit, prandaj prej saj mund të hahet, të jepet sadeka apo të dhurohet. Akika bëhet në kuadrin e falënderimit të Allahut, prandaj ajo hahet, por edhe mund të ruhet duke mos e shpërndarë. Më e mira, më plotë dhe më e hijshme është që ajo t’i shpëndahej të varfërve dhe shokëve, qoftë edhe pak. Gjithashtu prej kushteve të Akikas është që kafsha të mos të ketë të meta fizike, ashtu siç është kusht edhe tek kurbanit.

Disa çështje që lidhen me Akikan:

1- Një pjesë e dijetarëve janë shprehur se kafshës së Akikas nuk i thyhen kockat, duke u argumentuar se kjo bëhet në shenjë optimizmi për shëndetin e fëmijës. Ky qëndrim nuk ka asnjë argument prej fjalës së Allahut a.s. dhe as prej fjalës së Profetit a.s. Për këtë arsye nuk ka asgjë të keqe nëse kafshës se therur i thyhen kockat.

2- Bërja e Akikës për veten në moshë të madhe, nëse babai nuk i ka patur mundësitë ta bënte për fëmijën e vet. Kjo është nuk është e vlefshme, për arsye se obligimet bien nëse personi i ngarkuar nuk i ka mundësitë që ta realizojë detyrimin e vet. Por nëse Akika është lënë për shkak të neglizhencës së babait, atëherë personi mund të bëjë Akika për veten e tij. Ibn Serini thotë: “Po ta dija që babai im nuk ka bërë Akika për mua, do ta kisha bërë një të tillë për veten time.”

3- A lejohet t’i jepet jobsimtarit një pjesa nga Akika?

Jobsimtarit mund t’i jepet sadeka një pjesë e Akikas nëse muslimanët nuk kanë asnjë dëm apo lëndim prej tij. Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: “Allahu nuk ju ka ndaluar ju, që për ata që nuk ju kanë luftuar dhe as nuk ju kanë nxjerrë nga shtëpitë tuaja, të bëni bamirësi dhe të tregoheni të drejtë me ta.” (Mumtehine, 8).

4- A ka Akika për foshnjën e dalë?

Nëse fëmija që ka dalë nga barku i nënës para kohe është në muajin e pestë dhe më shumë, atij i ka hyrë shpirti, i vihet një emër dhe theret Akika për të. Kjo është më e mirë, por nuk është e detyrueshme. Nëse fëmija i dalë është në muajin e katër dhe më poshtë, atëherë atij nuk i vihet emër dhe as nuk falet namaz xhenaze për të. Ai mund të varroset në çdo vend dhe nuk theret Akika për të.

Disa dobi të Akikas:

1- Në ditën e shtatë duhet të rruhet koka e djalit dhe me peshën e flokëve të tij në argjend të jepet sadeka. Kjo mund të bëhet në rast se gjendet një berber që mund të rruajë kokën e fëmijës dhe nëse nuk gjendet dhe personi dëshiron të japë sadeka sa pesha e flokëve të fëmijës në argjend, atëherë nuk është e nevojshme. Mesa duket rruajtja e flokëve në këto ditë ka ndikim pozitiv në rritjen e flokëve më pas. Nëse është e vështirë për të gjetur një berber për të rruajtur kokën e fëmijës për shkak të lëvizjeve të shumta që bën në këtë periudhë dhe brisku mund të rrezikojë prerjen e kokës, atëherë personi mund të mjaftohet me dhëniën e sadeka sa pesha e flokëve në argjend duke e përcaktuar peshën e tyre me afërsi.

2- Lejohet që për dy delet e djalit të bëhet Akika për njërin në një kohë të caktuar dhe tjetren pas një muaji, sepse nuk është kusht që të dyja delet të bëhen Akika në të njëjtën kohë. Gjithashtu lejohet që njëra të theret në një vend dhe tjetra në një vend tjetër.

3- Akika nuk vlen për disa persona menjëherë. Kështu delja nuk vlen për dy foshnje, as lopa nuk vlen për dy vetë, as për tre dhe as për katër.

4- Nëse rast se vdes babai i foshnjës, nëna kryen detyrën e tij me zëvendësim.

5- Akika duhet të bëhet nga bagëtitë. Kështu ajo nuk vlen nëse bëhet me një kalë.

Përktheu: *boxhë* Genc Plumbi

Etikë/ Disa rregulla të “odës”

Nga hoxhë Ulvi Fejzullahu

E kam fjalën për një rregullsi kur të shfletohet, lexohet profili e një miku a dashamiri. Vlerat e trashëguara na orientojnë për “terbije” në çdo gjë. Por gjithsesi “terbije” edhe kur shfleton Facebook-un e tjetrit, ose kur jep ndonjë koment, vërejtje, sugjerim, këshillë, fyerje a kërcënim të gjitha këto nuk duhet të bëhen me “edepsëzllik”.

Çka t’i bësh, ndonjëherë njeriu, po përballet me tyrli “edepsëzi” e “pizevengu” dhe po detyrohesh mi thonë “mshelle gojën” e testaturës, ose po duhet me kap për “veshi” e ndokënd për “krahu” me i dhënë “delete” besa edhe jo rrallë po bën vaki me e “leçitë” me “block”.

Unë personalisht hapësirën e çdo kujt, pra profilin e çdo kujt në Facebook e llogaris si shtëpinë e tij me oborr. Tani janë të qartë rregullat e hyrjes në shtëpi, leje marrja, qëndrimi, kujdesi gjatë muhabetit, etj., deri sa etë merret “iza” për me ja mësy kah ke ardhur.

E gjithë shoqëria ime në Facebook për mua janë të respektuar dhe nderuar dhe e kanë statusin e mysafirit. Atëherë, për mysafirin respekt.

Kur jemi këtu te puna e mysafirit, personalisht unë kam disa lloj mysafir:

- Mysafir, që i kam thirr me ftesa, pra kam kërkuar që të më bëjnë “konak” dhe më kanë pranuar.

- Mysafir, që ata kanë kërkuar dhe i kam pranuar në shoqëri të Facebook.

- Mysafir që vinë deri në oborr dhe “kshyrin” se çka po bohet



dhe shkojnë, ku pe marr vesh që pata mysafir të paftuar, se po e qesin ndonjë guri, po i bie ndonjë “mbeturinë” e kështu diçka.

Tua them të drejtën pjesa dërmuese e mysafirve të mi në Facebook janë që më kanë trokit në derë për shoqëri dhe i kam pranuar, për këtë unë jam i nderuar. Dhe nuk ndodhë që dikush me trokit në derë e mos me ia hap derën.

Të nderuar mysafir!

Të gjithë po e dimë se po jetojmë në kohën moderne, ku janë bërë karashmak shumë hesape, besa edhe pak a shumë edhe kanë humbur disa rende. Tani sipas sjelljes së ndonjë mysafiri, që nuk po i dinë rendet e “odës”, si duhet me hy në “odë” e si duhet qëndruar, e bërë muhabet. Kështu që po

bëhen disa lëshime gabime me qëllim e paqëllim, me dije e padije, me axhamillëk e paaxhamillëk.

Sa për ilustrim: në “odë”, Facebook-u disa i bëjnë këto axhamillëk:

- nuk rrinë “komkryç” por i shtrin komt;
- shkon e derdh çajin;
- t’u pi ujë i zihet fryma;
- gjatë muhabetit serioz mendërmethon i pshton...;
- t’u fol aj tjetri ende pa mbaru muhabetin, ia merr fjalën;
- tjetri me dy net shkollë masdarke pleqnon, e çka ta lype puna;
- tjetri e pleqnon një ngatërrësë, del një tjetër pizeveng e prish hesapin;
- tjetri bohet gati “ndy guj” dhe thotë s’osht ashtu. Kur vetet: trego

pra si o? Përgjigjet: me ditë nuk e di, ama s’osht ashtu;

- e hesape tjera.....

Të nderuar!

Këshilloj mysafirët e mi, shumë të respektuar dhe nderuar. Kur vinë në odën (Facebook-un) time ta kenë një rend dhe vend, duke i pasur hije fjala dhe puna në konakun tim

Tjetra, dijeni se në “odën” time unë i kam caktuar rregullat. Prej rregullave:

- myslimani duhet mu mundu me fol mirë apo me hesht;

- ma sevap me ruajt abdesin, mos me prishë;

- mos me derdh çajin, e mos me përly kmishën;

- me bo rahmet n’rininë;

- me e nderu pleqninë;

- me dhënë vend d’ishmit;

- me msu padijshmin;

- me kallxu hakin me rend e me vend; etj..

- mos me prish dy veta mexhlin: ai i cili di me fol e nuk fol dhe ai cili s’di me fol e folë.

Nëse, ma prishin rendin në odë, ma boni hallall, por duhet me bo njonën prej ktyne:

- ose me i thonë: merr “izën”;

- ose duhet me kap për zilife, krahu me i thonë: mbylle derën prej jashti;

- ose me leçitë me “blocke”.

Allahu ju nderoftë të gjithëve.

I jam mirënjohës të gjithë xhematit tim në Facebook, të cilët janë me mijëra, 98% e tyre janë në nivel, e këto rregulla ia tregova vetëm 2%.

Shumë selame.

Ndalimi i përgojimit

• Nga Abdullah ibn Umeri transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Mos i përgojoni muslimanët dhe mos ndiqni të metat e tyre sepse ai që ndjek të metat e tyre Allahu do t’ia ndjekë të metat e tij. E kujt ia ndjek Allahu të metat do ta demaskojë qoftë dhe brenda shtëpisë së tij.” Transmetuan Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

• Nga Ebu Hurejre transmetohet se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “A e dini çështje gibeti?” Të pranishmit i thanë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë.” Profeti (a.s.) shtoi: “Të përmendësh vëllain tënd për dicka që ai e urren.” E pyetën: “Po sikur atë gjë

që po them ta ketë vërtetë në veten e tij?” Profeti (a.s.) tha: “Në qoftëse te ai gjendet çfarë po thua e je përgojuar atë, e nëse po thua dicka që ai nuk e ka atëherë po shpif për të.” Transmetoi Muslimi

• Nga Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) përcillet se i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Kur kam bërë udhëtimin e Miraxhit, kalova te një grup njerëzish që i kishin thonjtë prej bakri dhe me to cirrnin fytyrat dhe gjokset e tyre. Thashë: Kush janë këta njerëz o Xhibril? Xhibri u përgjigj: “Këta janë ata që hanë mishin e njerëzve dhe flasin për nderin e tyre.” Transmetoi Ebu Davudi



MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Histori/ METODAT DHE RRUGËT QË U PËRDORËN KUNDËR THIRRJES ISLAME

Kur i dërguari i Allahut a.s. shfaqti thirrjen e vet dhe e deklaroi haptazi të vërtetën bashkë me shokët e vet, ata u përballen me format më të ashpra të dhunës fizike dhe psikologjike. Kur kurejshët i zuri frika e përhapjes së thirrjes islame jashtë Mekës, ata menduan disa rrugë dhe forma për ta eliminuar këtë thirrje që në djep. Ndër to ishin:

1- Tallja, shpërfillja dhe përgënjeshtrimi

Përmes këtyre metodave kurejshët synonin të poshtëronin muslimanët dhe të dobësonin forcën e tyre shpirtërore. Kështu ata e akuzuan të dërguarin e Allahut a.s. me akuza qesharake dhe iu drejtuan me ofendime mendjelehta. Ata e thërrisnin atë “i çmenduri”. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe thanë: ‘O ti që të ka zbritur përkujtimi (Kurani), vërtet ti je një i çmendur.’** (El Hixhr, 6).

Ata gjithashtu e akuzuan për magji dhe gënjeshtria: **“Ata u habitën që nga mesi i tyre erdhi dikush që t’u tërhiqte vëmendjen dhe thanë ky është një magjistar gënjeshtar.”** (Sad, 4)

Ata e prisnin dhe e përcillnin të dërguarin e Allahut a.s. me shikime të vrenjtura dhe me ndjenja rebeluese: **“Për pak sa ata që kanë mohuar nuk të shqyen me shikimet e tyre kur dëgjuan përkujtimin (Kuranin) dhe thonë ky është i çmendur”** (Kalem, 51).

Kur pranë tij uleshin disa nga sahabët e pafuqishëm, kurejshët talleshin me ta dhe thonin : “këta janë shokët e tij”, por Allahu i Lartësuar i përgjigjej thënieve të tyre me fjalët: **“A nuk është Allahu më Dijsmi për ata që falënderojnë?”** (En’am, 53). Gjendja e jobsimtarëve ishte ashtu siç na sqaron Allahu i Madhëruar: “Ata që bënë krime talleshin me ata që kishin besuar dhe kur kalonin pranë tyre i shkelnin syrin njëri-tjetrit. Nëse shkonin tek familjarët e tyre shkonin duke u tallur me ta dhe nëse i shihnin thonin: **“Këta janë të humburit” por ata nuk janë dërguar mbikqyrës mbi ta.**” (Mutafinë, 29-33).

Kurejshët i shtuan së tepërmi talljet, po ashtu edhe akuzat dhe shpërfilljen. Këto patën ndikim në anën shpirtërore të dërguarit të Allahut a.s., për të cilën Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne e dimë që ti ndihesh ngushtë prej fjalëve që thonë”** (El Hixhr, 97). Më pas Allahu i Lartësuar i jep zemër duke ia larguar shqetësimin kur i thotë: **“Madhëroje Zotin tënd, bëhu prej atyre që bien në sexhde dhe adhuroje Zotin tënd derisa të vijë vdekja e sigurtë”.** (El Hixhr, 98-99). Më përpara Allahu i Lartësuar e kishte njoftuar se Ai i mjafton Profetin në luftën kundër këtyre njerëzve tallës, kur thotë: **“Ne të mjaftojmë ty kundër tallësve, të cilët bashkë me Allahun bëjnë edhe një zot tjetër, por ata do ta marrin vesh”** (El Hixhr, 95-96). Gjithashtu Allahu i Lartësuar e njofton se veprat e tyre do të kthehen kundër tyre një ditë: **“Përpara teje janë tallur me disa profetë të tjerë dhe ata që u tallën prej tyre i zuri tallja**

që bënë.” (En’am, 10).

2- Përhapja e dyshimeve dhe shpifja e pretendimeve të kota

Idhujtarët përhapnin dyshime dhe lajme të rreme në mënyrë që njerëzit të mos kishin mundësi të mendonin rreth ftesës së të dërguarit të Allahut a.s.. Idhujtarët thonin rreth Kuranit se ai është: **“Endrra të përziara”** (Enbija, 5), të cilat Muhamedi i sheh natën dhe i tregon ditën, madje ata thonin: “I ka shpikur” prej vetes së tij dhe se “ato ia mësojnë njerëzit” dhe se: **“Këto janë shpifje që ai i ka shpikur dhe për to e kanë ndihmuar njerëz të tjerë”** (Furkan, 4). Pra ata pretendonin se shokët e vet e ndihmonin Muhamedin për të shpikur fjalët e Kuranit dhe thonin: **“Dhe thanë: ‘Këto janë legjenda të të parëve, që i diktohen atij në mëngjes dhe mbrëmje’** (Furkan, 5).

Ndonjëherë idhujtarët shpreheshin se Muhamedi kishte një xhind ose shejtan me vete që i zbriste atij ashtu si i zbresin shejtanët magjistarëve dhe Allahu i kundërpërgjigjej me fjalët: **“A t’ju njoftoj se kujt i zbresin shejtanët? Ata i zbresin gjithkujt që mashtrojnë dhe gjynahmadh”** (Shuara, 221-222), që do të thotë se ata i zbresin njeriut gënjeshtar, të prishur dhe të mbuluar me gjynahe. Ju nuk më keni njohur më parë për gënjeshtria dhe as për njeri të prishur, atëherë si mund të pretendoni se Kurani është shpallje prej shejtanëve?!

Ndonjëherë idhujtarët pretendonin se i dërguari i Allahut a.s. vuante nga çmenduria dhe si pasojë ai i imagjinonte disa botëkuptime, të cilat i formulonte në fjalë të bukura dhe të mrekullueshme, ashtu siç veprojnë poetët. Në këtë mënyrë ai është poet dhe fjalët e tij janë poezi. Allahu i Lartësuar i përgjigjej me fjalët: **“E për sa u përket poetëve (që Muhamedi nuk është i tillë), ata i ndjekin të humburit (nga e vërteta). A nuk sheh se ata hidhen në çdo anë (sa lavdërojnë, sa përqeshin)? Dhe ata janë që flasin atë çka nuk punojnë?”** (Shuara, 225-226)

Këto janë tri karakteristika me të cilat dallohen poetët, ku asnjëra prej tyre nuk gjendet tek i dërguari i Allahut a.s., sepse ata që ndoqën Profetin a.s. ishin njerëz të udhëzuar, njerëz të devotshëm dhe vepërmirë në fenë, sjelljen, veprat dhe veprimet e tyre. Ata nuk vuanin nga asnjë humbje dhe devijimi në asnjë aspekt të jetës. Gjithashtu, i dërguari i Allahut a.s. nuk shpërqëndrohej në çdo temë, ashtu siç ndodh me poetët, por ai bente thirrje drejt një Zoti të Vetëm, drejt një feje të vetme dhe drejt një rruge të vetme. Ai nuk thoshte vetëm se atë që vepronte dhe bënte vetëm atë që thoshte. Çfarë lidhje kishte ai me poetët dhe poezinë dhe çfarë lidhje kishin poetët dhe poezia me të?

I dërguari i Allahut a.s. i përgjigjej atyre me përgjigje bindëse rreth çdo dyshimi që përhapej kundër tij, kundër Kuranit dhe Islamit. Pjesa më e madhe e dyshimeve që hidheshin nga

idhujtarët kishin të bënin me njësimin e Allahut, më pas në lidhje me mesazhin e të dërguarit të Allahut a.s., pastaj në lidhje me ringjalljen e të vdekurve dhe tubimin e tyre në Ditën e Gjykimit. Kurani Famëlartë i jepte përgjigje të gjitha dyshimeve të tyre rreth njësimin të Allahut, madje jepte sqarime shtesë, duke e trajtuar çështjen nga të gjitha anët. Allahu i Madhëruar e ka sqaruar pafuqinë e zotave të tyre në mënyrë të atillnë që nuk më nevojë për sqarim. Kjo shkaktonte zemërimin e idhujtarëve dhe shtonte këmbënguljen e tyre në qëndrimin e tyre mohues, që më pas solli ato pasoja që solli.

Përsa i përket dyshimeve të hedhura prej tyre në lidhje me mesazhin e të dërguarit të Allahut a.s., edhe pse idhujtarët e pranonin sinqeritetin, vërtetësinë, amanetin, devotshmërinë dhe mirësinë e tij, përsëri ata besonin se pozita e profetisë është më e vlefshme se t’i jepej një njeriu. Për ta njeriu nuk mund të ishte një profet dhe profeti nuk mund të ishte një njeri, sipas bindjeve të tyre. Kur i dërguari i Allahut a.s. shpalli haptazi besimin e yij dhe u bëri thirrje njerëzve që të besonin, idhujtarët mbetën të hutuar dhe thanë: **“Si e ka punën ky profet, që han ushqim dhe ecën nëpër tregje?”** (Furkan, 7). Idhujtarët thanë se Muhamedi është njeri: **“A i ka zbritur Allahu diçka një njeriu?”** (En’am, 19). Allahu i Lartësuar u përgjigj: **“Thuaj (o Muhamed): ‘Kush e zbriti librin që solli Musai si dritë dhe udhëzim për njerëzit?’”**

Ata e dinin dhe e pranonin se Musai a.s. ishte njeri, prandaj Kurani u bëri me dije se çdo popull i ka thënë profetit të vet në shenjë mohimi se: **“Edhe ju nuk jeni gjë tjetër veçse njerëz si ne”** (Ibrahim, 10) dhe: **“Profetët u thanë atyre: ‘Ne jemi njerëz si ju, por Allahu i jep mirësi kujt të dëshirojë nga robërit e Tij.’”** (Ibrahim, 11)

Pra të gjithë profetët janë njerëz dhe nuk ka asnjë kontradiktë mes qenies së tyre njerëz dhe profecisë, për më tepër idhujtarët e pranonin se Ibrahim a.s., Ismaili a.s. dhe Musai a.s. ishin njerëz dhe profetë njëkohësisht. Pë këtë arsye idhujtarët nuk gjetën asnjë hapësirë për të justifikuar dyshimet e tyre, ndaj kaluan në një justifikim tjetër duke thënë se a nuk gjeti Allahu për të zbritur mesazhin e Tij dikë tjetër në vend të këtij jetimi të varfër? Përsa Allahu braktisi parinë e Mekës e Taifit dhe zgjodhi këtë mjeran si profet?

Allahu i Lartësuar thotë: **“Pastaj thanë: ‘Përsa të mos i ketë zbritur ky Kuran një njeriu të madh nga këto dy qytete?’** (Zuhruf, 31). Më pas Allahu xh.sh. u përgjigjet: **“A këta e ndajnë mëshirën e Zotit tënd?”** (Zuhruf, 32). Kjo do të thotë se shpallja është mëshirë prej Allahut, prandaj: **“Allahu e di se ku e vendos shpalljen e Vet”** (En’am, 124)

Më tej idhujtarët kaluan tek një dyshim tjetër dhe thanë se profetët janë mbretër të dynjasë dhe ecin duke u

shoqëruar nga një varg skllëvërish dhe shërbëtorësh, kënaqen me autoritetin dhe pozitën e tyre, dhe atyre u sigurohen të gjitha lehtësitë për një jetë të mirë. Por si është e mundur që Muhamedi bredh nëpër tregje për të siguruar bukën e gojës dhe pretendon se është profet? Allahu i Lartësuar thotë: **“Si është puna e këtij profeti që ha ushqim dhe ecën nëpër tregje? Përsa të mos i jetë dërguar një engjell së bashku me te, e të jetë qortues? Ose atij t’i jepet ndonjë thesar, apo të ketë ndonjë kopsht nga i cili do të ushqehet? Zullumqarët madje thonë: ‘Ju vetëm jeni duke e ndjekur një njeri që e ka zënë magjia!’”** (Furkan, 7-8). Kurani Famëlartë i dha përgjigje dyshimit të tyre duke ua bërë të qartë se Muhamedi ka për detyrë të përcjellë shpalljen e Allahut, çdo gjë të vogël apo të madhe që i përcillet, sido që të jetë gjendja e tij; i dobët apo i fortë, me pozitë apo pa pozitë, i lirë apo skllav. Nëse do të jetonte si të dërguarit e mbretërve në mesin e shërbëtorëve dhe skllëvërve, me të gjitha të mirat e kësaj jete, ai nuk do të kishte mundësi që të mbërrinte me mesazhin e tij tek njerëzit e dobët që të përfitonin prej tij, të cilët përfaqësojnë pjesën më të madhe të njerëzve. Në këtë mënyrë do të humbiste dobia e shpalljes dhe nuk do të kishte pasur asnjë dobi prej saj.

Përsa i përket mohimit ringjalljes pas vdekjes idhujtarët nuk kishin asnjë argument përveç habisë dhe pamundësisë llogjike për të ndodhur, prandaj ata shpreheshin: **“A pasi të vdesim ne e të bëhemi dhë e eshtra të kalbur, a do të ringjallemi? A edhe të parët tanë të hershëm?”** (Saffat, 16-17) dhe thonin: **“Ai kthim është larg (mendjes e mundësisë!)”** (Kaf, 3). Gjithashtu me habi ata shpreheshin: **“A doni t’ju tregojmë për një njeri që do t’ju informojë juve se si, pasi që (të vdisni e) të jeni copëtuat plotësisht, ju do të krijoheni rishtazi? A është duke krijuar gënjeshtër ndaj Allahut, apo e ka kapur çmenduria?”** (Sebe, 7-8).

I dërguari i Allahut a.s. i përgjigjej duke ua bërë të qartë se çfarë ndodh në dynja në të vërtetë, ku njeriu zullumqar vdes pa e marrë dënimin e merituar, ndërsa ai që i është bërë padrejtësi vdes pa e marrë hakun që i takon prej njeriu të padrejtë, njeriu bamirës vdes pa e marrë shpërblimin e veprës së tij të mirë, ndërsa njeriu i prishur vdes përpara se të ndëshkohet për veprën e tij të keqe. Pra nëse nuk do të kishte ringjallje, as jetë pas vdekjes dhe shpërblim pas saj, atëherë të dyja palët do të ishin të të njëjtit rang, madje zullumqari dhe njeriu i prishur do të kishin qenë më të lumtur se njeriu i drejtë dhe se ai që i kanë bërë padrejtësi. Por kjo llogjikë është e papranueshme në mënyrë kategorike dhe nuk i takon Allahut që të ndërtojë sistemin e krijimit të Tij mbi këtë rregull të prishur. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar thotë: **“A do**

Gruaja/ SI MUND TË PËRFITTOJË GRUAJA NGA DITA E XHUMA?

Është për t'u dëshpëruar kur shikon realitetin e disa njerëzve dhe shpërfilljen që i bëjnë kohës, sidomos atyre periudhave kohore që kanë mirësi, edhe pse e dinë fare mirë që jeta është e shkurtër edhe nëse zgjat, se gëzimi përfundon shpejt edhe nëse zgjat, se shëndeti ndiqet nga sëmundja dhe rinia nga pleqëria.

Një nga kohët e begata të cilën e neglizhon një numër i madh njerëzish është dita e Xhuma, drejt të vlerave të cilës Allahu ka udhëzuar umetin e Muhamedit a.s. dhe ka privuar popuj të tjerë prej saj. Në këtë ditë është krijuar Ademi, në këtë ditë ka dalë nga Xheneti dhe në këtë ditë do të bëhet Kijameti: *"Nuk ka engjëll të afërt, as qiell, as tokë, as erëra, as male dhe as det që të mos ruhet prej ditës së Xhuma."* (E përcjell Ahmedi që e vlerëson hadith të mirë dhe e ka saktësuar Albani).

Pavarsisht këtyre vlera shohim se njerëzit e neglizhojnë këtë ditë. Për këtë arsye është me vend që të zbardhim disa të vërteta rreth kësaj dite, në mënyrë që të njohim peshën e saj të madhe dhe ta vlerësojmë siç duhet atë.

Madhështia e kësaj dite

Argumentet fetare që janë përcjellë në lidhje me mirësinë e kësaj dite janë të shumta. Nga Ebu Hurejre r.a. përcillet se ka thënë: *"Dita më e mirë në të cilën lind dielli është dita e Xhuma. Në këtë ditë është krijuar Ademi, në këtë ditë ka hyrë në Xhenet dhe në këtë ditë ka dalë prej tij."* (Muslimi)

Nga Eus bin Eusi r.a. përcillet se i



dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *"Dita juaj më e mirë është dita e Xhuma, prandaj shtojeni salavatit mbi mua, sepse salavati juaj më paraqitet mua."* (Ebu Daudi).

Ky është programi që propozohet për gratë në këtë ditë:

1- Gruaja të mos qëndrojë zgjuar deri natën vonë, sepse qëndrimi zgjuar vonë e bën atë që të humbasë namazin e sabahut dhe qëndrimin në vendin e faljes së vet për të përkujtuar Allahun dhe për lexuar Kuran. Ibn Mesudi r.a. thotë: *"I dërguari i Allahut a.s. na ka kritikuar për qëndrimin zgjuar pas jacie."* (E përcjell Ahmedi dhe e ka saktësuar Albani).

2- Gruaja mund të qëndrojë në vendin që falet pas namazit të sabahut për të bërë dhikër dhe për të lexuar Kuran.

3- Leximi i sures Kehf, sepse janë përcjellë argumente të shumta në lidhje me mirësinë e leximit të kësaj sureje ditën e Xhuma. Ndër to është hadithi që përcjell Daremiu në Sunenin e tij nga Ebu Seid el Huderiu r.a. që thotë: *"Kush e lexon suren Kehf natën e Xhuma, atij do t'i ndriçojë një dritë që fillon prej tij dhe mbaron në Shtëpinë e Lashtë (Bejtu Atik)."* (Albani thotë hadith merfu).

4- Pas ikindie gruaja mund ta shfrytëzojë këtë kohë për të vizituar një të afërm, apo një të sëmurë, ose për të përsëritur diçka që e ka mësuar.

5- Pak para akshamit duhet shfrytëzuar kjo kohë për t'iu përkushtuar lutjes dhe për të shfrytëzuar kohën që lutja merr përgjigje. Në dy Sahihët përcillet nga Ebu Hurejre r.a. se i dërguari i Allahut a.s. përmendi ditën e Xhuma dhe tha:

persë dhe thoshte: *"Përse Muhamedi fliska gjëra më të bukura se ato të miat?!"*

Nga Ibn Abasi r.a. përcillet se Nadhri kishte blerë një herë një këngëtare dhe sapo dëgjonte që dikush dëshironte të hynte në Islam, ai dërgonte këngëtaresh tek çadra e tij dhe i thoshte asaj: *"Jepi të hajë dhe të pijë dhe pastaj këndoi, sepse kjo është më e mirë se ajo që i bën thirrje Muhamedi."* Për këtë njeri ka zbritur edhe ajeti kuranor: *"Ka prej atyre njerëzve që blejnë argëtime për t'i humbur njerëzit nga rruga e Allahut"* (Lukman, 6).

4- Pazaret

Idhujtarët u përpoqën që injoranca dhe Islami të puqeshin në mes të rrugës, duke pranuar që ata të braktisin disa gjëra dhe i dërguari i Allahut a.s. të braktiste disa të tjera. Allahu i Lartësuar thotë: *"Ata kanë dëshirë që ti të bësh lajka, e që edhe ata të bëjnë lajka."* (Kalem, 9). Për këtë arsye Esved bin Abdulmutalibi bin Esed bin Abduluz, Velid bin Mugejra, Umejah bin Halefi dhe El as bin Uail es-Sehemi, të cilën ishin jerëz me pozitë në popullin e tyre,

"Në të gjendet një orë që nëse muslimanit i përkon lutja e tij në të ndërsa falet dhe i kërkon Allahut diçka, Allahu do t'ia japë" dhe bëri shenjë me dorën e tij për të treguar që është një kohë fare e shkurtër."

Dijetarët kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me përcaktimin e kësaj ore, ku qëndrimi i saktë është se ajo është një orë në kohën e ikindisë. Për këtë arsye, kërkohet prej gruas muslimane që e njeh nevojën e saj për Zotin e vet, që ta shfrytëzojë këtë rast duke bërë lutje për veten dhe fëmijët e vet që Allahu t'i udhëzojë dhe t'i bëjë të qëndryshëm në këtë fe bashkë me të gjithë vëllezërit e tjerë muslimanë në lindje dhe perëndim.

6- Pas akshamit gruaja të përpiqet të ulet bashkë me familjarët e saj, fëmijët dhe vëllezërit e saj në shtëpi për të përfutuar nga ndonjë dije e dobishme apo për të përfutuar ndonjë dije fetare, apo thjesht duke bërë biseda që shtojnë lidhjen dhe dashurinë mes tyre.

7- Pas namazit të jacisë, nëse dëshiron ajo mund të hajë ushqim ose mund të lexojë një libër dhe kjo e fundit është më e dobishme. Nëse dëshiron mund të falë namazin e Vitrit përpara se të flejë duke mos harruar lutjet e gjumit dhe rregullat e tij ose nëse dëshiron ta vonojë faljen e Vitrit, atëherë mund flejë gjumë me nijetin se do të ngrihet për të falur namazin e natës dhe pas tij të falë namazin e Vitrit. Në kohën e syfyrit pëlqehet që gruaja t'i drejtohet Krijuesit e saj me përlulesi dhe bindje. Ky është një program i shkurtër dhe i lehtë që mund të jetë i dobishëm për ato gra dhe burra që Allahu ua lehtësuar adhurimin.

... Vijon nga faqja 6

t'i bëjmë kriminelët të barabartë me muslimanët? Ç'është me ju, si gjykoni ashtu?" (Kalem, 35-36).

Kjo ishte përgjigje për të gjithë ata që hidhin dyshime, një përgjigje e llogjikshme dhe prerë për ata që mendonin, por idhujtarët ishin mendjemëdhën dhe kërkonin të kishin pushtet në tokë dhe të impononin mendimin e tyre mbi të tjerët. Në këtë mënyrë ata mbetën të hutuar në humbjen e tyre.

3- Pengimi i njerëzve për të dëgjuar Kuranin dhe kundërshtimi i tij me pretendimin se është fjalë nga legjendat e njerëzve të parë

Përveç përhapjes së dyshimeve idhujtarët përpiqeshin që të pengonin njerëzit nga dëgjimi i Kuranit dhe nga thirrja islame me të gjitha rrugët dhe mënyrat. Ata i dëbonin njerëzit dhe shkaktonin trazira, këndonin dhe luanin. Kur e shikonin se i dërguari i Allahut a.s. po bëhej gati për të thirrur

njerëzit në Islam ose kur e shihnin që po falej dhe po lexonte Kuran, thonin siç e përshkruan Allahu i Lartësuar: *"Ata që nuk besuan thanë: "Mos e dëgjoni këtë Kuran dhe kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë (bërtitni) ashtu që ta pengoni!"* (Fussilet, 26) në mënyrë që i dërguari i Allahut a.s. të mos kishte mundësi që të lexonte Kuran në vendet ku ata mblidheshin dhe takoheshin, vetëm në vitin e pestë hixhri ku i dërguari i Allahut a.s. filloi të shfaqej qëllimisht para tyre në mënyrë të befasishme dhe e pa e ndjerë përpara se të fillonte leximin e Kuranit.

Nadhr bin Harithi ishte një prej shetanëve të Kurejshëve, i cili kur u kthye nga Hajra kishte mësuar tregimet e mbretërve të Persisë, Rustumit dhe Sfondjarit. Sa herë që i dërguari i Allahut a.s. merrte pjesë në një kuvend për t'iu kujtuar njerëzit me Allahun dhe për t'ua tërhequr vëmendjen prej ndëshkimit të Tij, pas tij vinte Nadhri që thoshte: *"Unë pasha Allahun mund t'ju tregoj gjëra më të bukura se ky"*. Pastaj ulej me njerëzit dhe u tregonte historitë e mbretërve

u mblodhën dhe i thanë: *"O Muhamed! Le të adhurojmë këtë adhurojmë dhe ti le të adhurosh kë të adhurosh, prandaj le të bëhemi bashkë në këtë çështje. Nëse Ai që ti adhuron është më i mirë se ai që ne adhurojmë, atëherë edhe ne do të kemi pjesën tonë në adhurimin e tij dhe nëse ai që ne adhurojmë është më i mirë se Ai që adhuron ti, atëherë edhe ti do të kesh marrë pjesën tënde në adhurimin e tij."* Pas kësaj Allahu i Lartësuar zbriti ajetet që flisnin për ta: *"Thuaj: "O ju jobsimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuron! As ju nuk jeni adhures të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhures i asaj që ju adhuron! Por edhe ju nuk do të jeni adhures të Atij që unë e adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!"* (Kafirun, 1-6)

Pra këto dhe tjera ishin metodat e idhujtarëve për të penguar thirrjen islame, por Allahu ua çoi dëm mundin dhe e ndihmoi Profetin e Vet, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi të deri në Ditën e Fundit.



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
 Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
 Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
 Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
 Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
 Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
 Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
 Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
 Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
 Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
 rrugica përballë
 xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
 Cel: 0672812607 / 0672821589

www.produktenatyrale.com
 Email: agimballa@hotmail.com



SHKOLLA 9 VJEÇARE "HAFIZ ALI PODGORICA" DURRËS

*Njoftojmë të gjithë dashamirësit dhe të interesuarit
 se në qytetin e Durrësit kanë filluar regjistrimet në
 shkollën 9 vjeçare të shumëpritur "Hafiz Ali Podgorica".*



Në mesin e shoqërisë ku jetojmë ku shturja, degjenerimi, e plot probleme të tjera morale kanë zënë rrënjë, shkolla 9 vjeçare "Hafiz Ali Podgorica" ju ofron edukim, arsimim të kualifikuar, komoditet, moral të lartë dhe disiplinë shembullore, me një staf të përzgjedhur pedagogjik dhe me pëgjegjësi të lartë profesionalizmi dhe morali.

Përveç kurrikulës standarte, shkolla 9 vjeçare "Hafiz Ali Podgorica" jashtë programit mësimor ofron për të interesuarit mësim Kurani dhe edukatë islame.

Mos hezitoni të siguronit fëmijën tuaj. Investimi më i rëndësishëm që mund të bëni është investimi për fëmijët tuaj duke iu siguruar atyre arsimim, moral dhe disiplinë sipas normave islame.

Arsimim, moral dhe edukatë islame



Për më tepër informacion mund të kontaktoni në:

Cel: 00355 67 26 08 302; 00355 67 38 28 306